

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:		Refike Sülçevsi, Zv.Sekretare e Përgjithshme në MZHR <i>R. S. S. S.</i>			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:		Arbnor Sadiku, Zv. Drejtor i DIEKP-së <i>AS</i>			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Kërkesë për aprovimin dokumentit shpjegues për Politikat e BE-së për Zhvillim Rajonal			
Nr. i zyrës:	318	Lokacioni:	Ndërtesa e dytë	Data:	8/12/2025
Br. kancelarije:		Kucni:	Qeveritare (ish -	Datum:	
Room No.:		Extension:	Rilindjes) kati i III- të	Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					☐
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					☒
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					☒
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					☐
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS					☐
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					☐
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					☐
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					☐
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					☐
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					☐
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

E nderuara Sekretare Sülçevsi,

Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave ka përgatitur dokumentin shpjegues mbi politikat e Bashkimit Evropian për zhvillim rajonal, me qëllim të ofrimit të një pasqyre të qartë dhe të përditësuar të kuadrit strategjik, objektivave dhe mekanizmave mbështetës të BE-së në këtë fushë.

Dokumenti analizon politikat kyçe të kohezionit, instrumentet financiare për zhvillim rajonal, si dhe praktikatat e mira që shtetet anëtare dhe vendet në proces të integritetit evropian kanë zbatuar në harmonizim me politikatat e BE-së.

Ky material synon të shërbejë si bazë orientuese për MZHR-në në procesin e planifikimit dhe zbatimit të politikave zhvillimore, si dhe për përputhjen e tyre me standardet dhe kërkesat evropiane.


Pas aprovimit tuaj, dokumenti do të procedohet për publikim në ueb-faqen zyrtare të MZHR-së.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL
MINISTARSTVO ZA REGIONALNI RAZVOJ
MINISTRY OF REGIONAL DEVELOPMENT

DOKUMENTI SHPJEGUES I POLITIKAVE RAJONALE NË BASHKIMIN EVROPIAN.



DEPARTAMENTI PËR INTEGRIME EVROPIANE
DHE KOORDINIM TË POLITIKAVE
2025

Përmbajtja :	1
I. Hyrje.....	2
II. Nocionet e zhvillimit rajonal.....	3
III. Planifikimi ekonomik rajonal.....	4
IV Koncepti.....	5
V. Objektivat.....	6
VI. Prioritetet.....	7
VII. Programet.....	9
VIII. Nuts (rajonet statistikore).....	10
IX. Mundësitë e Kosovës për përfshirje.....	12

Shkurtesat:

BE	Bashkimi Evropian
FEZHR	Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal (ERDF)
MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
PBB	Produkti Bruto i Brendshëm (GDP)

Hyrje

Hartimi i dokumentit shpjegues lidhur me politikat rajonale të Bashkimit Evropian (BE)-së, do të përpiqet të sqarojë mënyrën se si BE-ja i është qasur hartimit të politikave, dhe përcaktimit të objektivave, prioriteteve, programeve, shpërndarjes së fondeve me qëllim të zhvillimit të vendeve më pak të zhvilluara, siç është Kosova, dhe më gjerë.

BE-ja, në veçanti synon t'i qaset zhvillimit rajonal ndaj vendeve që synojnë të jenë pjesë e Unionit Evropian duke përfshirë këtu edhe Ballkanin Perëndimor, ku bën pjesë edhe Kosova.

Dokumenti shpjegues për politikat rajonale në Bashkimin Evropian, pasqyron zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal, të inkorporuar si: objektiva, prioritete dhe koncepte, që ofrojnë mundësi të barabartë për zhvillim të balancuar rajonal.

Kosova, siç dihet ka hyrë në dekadën e tretë të shtetësisë së vet, dhe si vend i tillë ka nevojë për fonde nga jashtë, për të rritur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Andaj, bazuar në këtë edhe Bashkimi Evropian nëpërmjet politikave të zhvillimit rajonal përqendrohet në marrjen e masave dhe ofrimin e instrumenteve për nxitjen e zhvillimit të rajoneve të pazhvilluara duke pasur parasysh zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë kombëtare.

Pra në kontekstin që po flasim zhvillimi rajonal konceptohet si një përpjekje e përgjithshme për të reduktuar pabarazitë rajonale, duke mbështetur (punësimin dhe gjenerimin e pasurisë/mirëqenies) aktivitete ekonomike në rajonet zhvillimore.

Nocionet e zhvillimit rajonal

Në kushtet bashkëkohore të zhvillimit ekonomik politika e zhvillimit rajonal gjithnjë e më shumë po bëhet aktuale dhe pjesë përbërëse e politikës zhvillimore ekonomike. Para së gjithash, në situatën aktuale ku ndodhet stadi i zhvillimeve rajonale, nuk mundet të tolerohet koncentrimi i aktiviteteve ekonomike dhe shoqërore vetëm nëpër disa qendra të mëdha por duhet të bëhet shpërndarja e forcave prodhuese, duhet të balancohet edhe niveli i zhvillimit investues, infrastrukturor, ekonomik, në tërë territorin e Kosovës. Diferencat apo pabarazitë e mëdha zhvillimore sjellin çrregullime të mëdha jo vetëm në fushën ekonomike por edhe në të gjitha sferat tjera jetësore sepse mungesa e zhvillimit ka implikime të drejtpërdrejta në jetën dhe në standardin jetësor të popullsisë.

Sot në burime zyrtare që prekin fushën e zhvillimit rajonal, hasim në mendime të ndryshme rreth kuptimit dhe rëndësisë së zhvillimit rajonal e që varet nga këndvështrimi ndaj këtij problemi i cili po zë vend të konsiderueshëm në politikën bashkëkohore të zhvillimit ekonomik.

“Zhvillimit rajonal është një përpjekje e përgjithshme për të reduktuar pabarazitë rajonale, duke u mbështetur në punësimin dhe gjenerimin e pasurisë/mirëqenies së aktiviteteve ekonomike në rajone.”¹

Por sidoqoftë:

“Politika e zhvillimit rajonal ka të bëjë me uljen e pabarazive ekonomike, në mes të rajoneve ekonomike zhvillimore, të Kosovës”.²

Në këtë kuptim politika e zhvillimit rajonal përfshin dy aspekte kryesore të ekonomisë së vendit, këto janë:

1. Nxiti në mënyrë racionale, mundëson shfrytëzimin e faktorëve të prodhimit në tërë territorin e vendit duke mundësuar zhvillimin sa më harmonik territorial;
2. Mundëson zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë kombëtare.

Në këtë kontekst, mund të kuptojmë se politika e zhvillimit rajonal bart në vete dy lloje politikash:

- politikën e zhvillimit; - politikën rajonale³, që së bashku paraqesin politikën e përgjithshme zhvillimore ekonomike të Kosovës.

Planifikimi ekonomik rajonal

Çdo vend duhet të jetë në gjendje të realizojë potencialin e tij, të shfrytëzojë fuqitë e tij lokale, t'i japë të gjithëve mundësinë për të fituar një jetesë të denjë dhe të jetë i suksesshëm kudo që ata zgjedhin të jetojnë.

Planifikimi rajonal nuk përfshin vetëm masat e përbashkëta për vënien e ekuilibrit ndërmjet rajoneve por është edhe artikulimi mes punës zgjidhjeve, instrumenteve dhe praktikës që duhet të sjellë politika rajonale për nivelin e secilit rajon.

Politika e zhvillimit rajonal në vete përfshin të gjitha masat dhe instrumentet që i ndërmerr shteti apo ndonjë njësi më e vogël administrative si: komuna, etj. Me qëllim të nxitjes së zhvillimit të rajoneve (rajoneve zhvillimore ekonomike) jo mjaft të zhvilluara, përkatësisht zhvillimin sa më harmonik territorial të ekonomisë kombëtare.

Andaj, siç e kemi potencuar edhe më lartë, politika e zhvillimit rajonal në vete nënkupton krijimin e kushteve të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të çdo rajoni (veç e veç) si pjesë përbërëse e tërësisë territoriale të vendit dhe ekonomisë kombëtare në tërësi.

Sot politika e zhvillimit rajonal përqendrohet në marrjen e masave dhe të instrumenteve për nxitimin e zhvillimit të rajoneve jo mjaft të zhvilluara duke pasur parasysh zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë kombëtare.

Nuk ka dyshim se të gjitha politikat zhvillimore kanë dimensionin hapësinor, pra nuk janë neutrale në aspektin e zhvillimit rajonal por ndikimi i tyre është i ndryshëm nëpër rajone të caktuara si pjesë përbërëse të ekonomisë kombëtare. Politika rajonale sikurse edhe politika e përgjithshme zhvillimore ka qëllimet e veta dhe duke pasur parasysh përmbajtjen e lëndës - qëllimet kryesore të politikës rajonale mund të grupohen në: vendosjen sa më të barabartë të forcave prodhuese, investuese, në pikëpamje ekonomiko-zhvillimore.

Konceptimi i dokumentit për hartim të politikave rajonale

Koncepti i këtij dokumenti mundëson që sadopak të ofrojë njohuri për qasjen e zhvillimit rajonal nga BE-ja, mënyrën se si BE-ja i është qasur hartimit të politikave, strategjive, mënyrës se si janë përcaktuar objektivat, prioritetet, programet, shpërndarja e fondeve me qëllim të zhvillimit të vendeve më pak të zhvilluara brenda vendeve anëtare të saj por edhe mënyra se si BE synon t'i qaset zhvillimit rajonal ndaj vendeve që synojnë të jenë pjesë e familjes evropiane duke përfshirë Ballkanin Perëndimor ku bën pjesë edhe Kosova.

Dokumentit shpjegues për politikat rajonale në Bashkimin Evropian, pasqyron zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal, të inkuorporuar, me vendbanime, ekonomi, infrastrukture dhe sisteme natyrore të balancuara, në një bashkësi hapësinore pa dallime si mundësi e barabartë për zhvillim të balancuar rajonal.

Zhvillimi rajonal konceptohet si një përpjekje e përgjithshme për të reduktuar pabarazitë rajonale, duke mbështetur (punësimin dhe gjenerimin e pasurisë/mirëqenies) aktivitete ekonomike në rajone zhvillimore.

Një prej sfidave janë pabarazitë rajonale në mes të rajoneve të caktuara. Ekzistojnë dallime substanciale në krahasim mes rajoneve në disa indikatorë socio-ekonomik (Produkti i Brendshëm Bruto PBB(GDP)/Kokë-banori(Capita); investime për kokë banori; niveli i papunësisë etj.). Procesi i uljes së dallimeve në aspekt të zhvillimit socio-ekonomik dhe cilësisë së jetës në rajone të ndryshme synohet përmes zhvillimit të balancuar ekonomik rajonal.

Politikat për zhvillim rajonal japin kornizën e zhvillimit rajonal dhe intervenimeve në fusha specifike të cilat do të drejtohen për arritjen e synimit të zhvillimit të balancuar rajonal;

Programe për zhvillim rajonal përmbajnë avantazhet e rajonit zhvillimor, duke definuar prioritetet zhvillimore të rajonit dhe që përmban programe të vlerësuara financiare për zhvillim dhe promovim të rajonit zhvillimor, definimi i prioritetëve zhvillimore të rajonit dhe programet e vlerësimit financiar për promovim zhvillimor në rajonin zhvillimor, sfidat, problemet dhe ngecjet në fushën e zhvillimit rajonal që duhen adresuar me qëllim të përafrimit me politikat e zhvillimit rajonal të BE-së. Përgatitja e dokumentit shpjegues është paraparë në Planin e Punës së MZHR-së 2020.

Objektivat e Bashkimit Evropian për zhvillim rajonal 2021 - 2027

Bashkimi Evropian - BE-ja ka përcaktuar objektivat e zhvillimit rajonal dhe politikat e kohezionit përtej vitit 2020. Ky kuadër i ri me një shikim është i përqendruar në pesë përparësi investimesh, ku BE do të nxisë investimet e saja për zhvillim rajonal në periudhën vijuese 2021-2027:

Investimet e zhvillimit rajonal do të përqendrohen fuqimisht në objektivat 1 dhe 2. 65% deri 85% të burimeve të Fondit Evropian të Zhvillimit Rajonal (FEZHR/ERDF) dhe Fondit të Kohezionit do të ndahen për këto përparësi, në varësi të pasurisë relative të shteteve anëtare si në vijim:

Objektivi i parë i politikave: Evropa e zgjuar përmes inovacionit, digjitalizimit, transformimit ekonomik dhe mbështetjes për bizneset e vogla dhe të mesme;

Objektivi dytë i politikave: Një Evropë e gjelbër: pa karbon, duke zbatuar Marrëveshjen e Parisit dhe duke investuar në tranzicionin e energjisë, energjinë e ripërtëritshme dhe luftën kundër ndryshimeve klimatike;

Objektivi i tretë i politikave: Një Evropë më e lidhur: me transport strategjik dhe rrjete digjitale;

Objektivi i katërt i politikave: Një Evropë më sociale: duke ofruar në Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale dhe duke mbështetur punësimin cilësor, arsimin, aftësitë, përfshirje sociale dhe qasje të barabartë në kujdesin shëndetësor;

Objektivi i pestë i politikave: Një Evropë më e afërt me qytetarët: duke mbështetur në strategji zhvillimi të udhëhequra lokalisht dhe zhvillim të qëndrueshëm urban në të gjithë BE-në.

Prioritetet e Bashkimit Evropian për zhvillim rajonal 2021 - 2027

Për buxhetin e ardhshëm afatgjatë të Bashkimit Evropian (BE)-së 2021-2027, Komisioni propozon të modernizojë politikën e kohezionit, politikën kryesore të BE-së për investime konkrete në zhvillimin e balancuar ekonomik.

Karakteristikat kryesore të propozimit të Komisionit për një politikë të modernizuar të kohezionit janë:

Prioriteti 1:⁴ Një përqendrim në përparësitë kryesore të investimeve, ku BE-ja është më e përshtatshme për të ofruar: Pjesa më e madhe e Fondit Evropian të Zhvillimit Rajonal dhe investimeve të Fondit të Kohezionit do të shkojnë drejt inovacionit, mbështetje për bizneset e vogla, teknologjitë digjitale dhe modernizimin industrial. Gjithashtu, BE-ja do t'i kushtojë fokus të madh zhvendosjes drejt një ekonomie të zhvilluar me karbon të ulët, dhe të luftës kundër ndryshimit të klimës, e bazuar në Marrëveshjen e Parisit. Gjatë rishikimit të këtyre politikave duke pasur parasysh rolin e bizneseve, pavarësisht nga madhësia e tyre, në drejtimin e kërkimit, inovacionit, transferimit të njohurive dhe teknologjisë, Komisioni ka propozuar të zgjerojë mbështetjen e Fondit Evropian të Zhvillimit Rajonal edhe për kompanitë e mëdha në fushat kritike, të tilla si: mbrojtja, teknologjitë strategjike dhe dekarbonizimi.⁵

Prioriteti 2: Një politikë kohezioni për të gjitha rajonet dhe një qasje më e përshtatshme për zhvillimin rajonal:

Investimi në të gjitha rajonet: Rajonet që akoma kanë mbetur në drejtim të arritjes ose të ardhurave - kryesisht të vendosura në Jug dhe Lindje të Evropës - do të vazhdojnë të përfitojnë nga mbështetja e rëndësishme e BE-së. Politika e kohezionit do të vazhdojë të investojë në të gjitha rajonet, pasi shumë prej tyre në të gjithë Evropën - përfshirë shtetet anëtare më të pasura - luftojnë për të arritur tranzicionin industrial, për të luftuar papunësinë dhe për të mbajtur një ekonomi të globalizuar;

Një qasje e përshtatur: Politika e kohezionit ndahet në tri kategori rajonesh:

- Rajone më pak të zhvilluara, në fazë tranzicioni dhe ato më të zhvilluara. Për të zvogëluar pabarazitë dhe për të ndihmuar rajone me të ardhura të ulëta dhe me rritje të ulët, PBB për frymë mbetet kriteri mbizotërues për shpërndarjen e fondeve. Për më tepër, kriteret e reja synojnë të pasqyrojnë më mirë realitetin në terren - papunësia e të rinjve, niveli i ulët arsimor, ndryshimi i klimës dhe pritja dhe integrimi i emigrantëve.

E udhëhequr nga lokacioni: Politika e Kohezionit 2021-2027 është një Evropë që fuqizon, duke mbështetur strategji zhvillimi të udhëhequra nga vendi. Autoritetet lokale, urbane dhe territoriale do të përfshihen më shumë në administrimin e

⁴ http://kub-pz.weebly.com/uploads/1/0/5/9/10591655/sllajdet_politika_e_zhvillimit_rajonal_ib1.pdf.

⁵ https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_25_929.

fondeve të BE-së, ndërsa nivelet e rritura të bashkëfinancimit do të përmirësojnë pronësinë e projekteve të financuara nga BE në rajone dhe qytete.

Prioriteti 3: Rregulla më fleksibile, më të qarta, si dhe më të shkurtra, dhe një kornizë më fleksibile⁶:

Thjeshtimi i qasjes në fonde - Komisioni propozon që rregullat të bëhen më pak komplekse në buxhetin e ardhshëm afatgjatë të BE-së, dhe me procedura më të lehta kontrolli për bizneset dhe sipërmarrësit që përfitojnë nga mbështetja e BE;

Një rregullore të vetme - Një grup rregullash tani mbulon 7 fonde të BE-së të implementuara në partneritet me shtetet anëtare ('menaxhimi i përbashkët'), i cili do ta lehtësojë jetën për menaxherët e programeve të fondeve të BE-së. Ai gjithashtu do të lehtësojë sendërgjje, për shembull midis fondeve të Politikës së Kohëzimit dhe Fondit të Azilit dhe Migracionit kur bëhet fjalë për zhvillimin e strategjive lokale të integritit për emigrantët. Kuadri gjithashtu lejon lidhje më efikase me fonde të tjera nga kutia e mjeteve të buxhetit të BE, për shembull, shtetet anëtare mund të zgjedhin të transferojnë disa nga burimet e tyre të Politikës së Kohëzimit në programin Invest EU.

Prioriteti 4: Një lidhje e forcuar me Semestrin Evropian për të përmirësuar mjedisin e investimeve në Evropë: Komisioni propozon të krijojë një mjedis rritjeje dhe miqësor të biznesit në Evropë, në mënyrë që BE-ja përmes investimeve kombëtare të mund të japin potencialin e tyre të plotë.

Programet e Bashkimit Evropian për zhvillim rajonal 2021 - 2027

Për bizneset dhe sipërmarrësit që përfitojnë nga mbështetja e BE-së, korniza e re ofron më shumë fleksibilitet, me mënyra më të thjeshta për të kërkuar pagesa duke përdorur opsione të thjeshtuara të kostos. Për të lehtësuar sinergjitë, një rregullator i vetëm mbulon 7 fonde të BE-së të implementuara në partneritet me shtetet anëtare ("menaxhimi i përbashkët"). Komisioni gjithashtu propozon kontrolle më të lehta për programet me rekord të mirë, me një besim të shtuar në sistemet kombëtare dhe zgjerimin e parimit të "kontrollit të vetëm", për të shmangur dyfishimin e kontrolleve.

⁶ https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/MEMO_18_3866.

Një kornizë më fleksibile - Kuadri i ri kombinon stabilitetin e nevojshëm në planifikimin e investimeve me nivelin e duhur të fleksibilitetit buxhetor për të përballuar ngjarje të paparashikuara. Një rishikim afatmesëm do të përcaktojë nëse ndryshimet në programe janë të nevojshme për dy vitet e fundit të periudhës së financimit, bazuar në përparësitë e shfaqura, performancën e programeve dhe rekomandimet më të fundit të veçanta të vendit. Brenda kufijve të caktuar, transferimi i burimeve do të jetë i mundur brenda programeve pa pasur nevojë për një miratim zyrtar të Komisionit. Një dispozitë specifike e bën më të lehtë mobilizimin e fondeve të BE-së që nga dita e parë në rast të një katastrofe natyrore. Komisioni Evropian momentalisht po rishikon politikën e kohezionit të BE-së për të mbështetur më mirë prioritetet kryesore si konkurrueshmëria, dekarbonizimi, mbrojtja, strehimi i përballueshëm, qëndrueshmëria ndaj ujit dhe tranzicioni energjetik. Iniciativa i inkurajon shtetet anëtare të riprogramojnë fondet e tyre të kohezionit për t'u përshtatur me këto qëllime strategjike, duke u përqendruar ende në uljen e pabarazive ekonomike, sociale dhe territoriale. Propozimet kryesore përfshijnë zgjerimin e mbështetjes për kompanitë e mëdha në sektorët strategjik, rritjen e investimeve në mbrojtje dhe rajonet kufitare lindore, dyfishimin e fondeve për strehim të përballueshëm, rritjen e qëndrueshmërisë ndaj ujit dhe promovimin e tranzicionit energjetik. Këto ndryshime do të diskutohen nga Parlamenti dhe Këshilli Evropian, me zbatimin që pritet deri në vitin 2026.

Një lidhje e forcuar me qeverisjen ekonomike të Bashkimit Evropian - Politika e kohezionit mbështet reformat për një mjedis miqësor për investimet, ku bizneset mund të lulëzojnë. Do të sigurohet plotësimi dhe koordinimi i plotë me programin e ri, të zgjeruar të mbështetjes së reformës. Rekomandimet specifike të vendit të formuluar në kontekstin e të ashtuquajturit Semestrit Evropian do të merren parasysh dy herë gjatë periudhës buxhetore: në fillim, për hartimin e programeve të Politikës së Kohezionit, dhe gjatë rishikimit afatmesëm. Për të vendosur më tej kushtet e duhura për rritje dhe krijim të vendeve të punës, kushtet e reja "mundësuese" do të ndihmojnë në heqjen e barrierave për investimet. Aplikimi i tyre do të monitorohet gjatë gjithë periudhës financiare.

Interreg: Heqja e pengesave ndërkufitare dhe mbështetja e projekteve të inovacionit ndër-rajona ⁷ - Bashkëpunimi ndër-rajonal dhe ndërkufitar do të lehtësohet nga mundësia e re që një rajon të përdorë pjesë të alokimit të vet për të financuar projekte kudo në Evropë së bashku me rajone të tjera. Brezi i ri i programeve të bashkëpunimit ndër-rajonal dhe ndërkufitar ("Interreg") do t'i ndihmojë shtetet anëtare të kapërcejnë

⁷ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/ALL/?uri=CELEX%3A32003R1059>.

pengesat ndërkufitare dhe të zhvillojnë shërbime të përbashkëta. Duke u bazuar në një veprim pilot të suksesshëm nga 2014-2020, Komisioni propozon krijimin e Investimeve Inovative Ndër-regjionale. Rajoneve me specializim të zgjuar 'do t'u jepet më shumë mbështetje për ndërtimin e grupimeve pan-Evropiane në sektor me përparësi siç janë të dhënat e mëdha, ekonomia qarkore, prodhimi i përparuar ose siguria në internet.

Rregulla të përforcuara për kryerjen më të mirë të investimeve në BE - Të gjitha programet do të kenë akoma një kornizë të performancës me objektiva të matshëm (numri i vendeve të punës të krijuara ose qasja shtesë në brez të gjerë). Kuadri i ri prezanton një rishikim të performancës vjetore, në formën e një dialogu politikash midis autoriteteve të programit dhe Komisionit. Performanca e programeve gjithashtu do të vlerësohet gjatë një rishikimi afatmesëm. Për arsye transparence, dhe kështu qytetarët mund të ndjekin përparimin e bërë, shtetet anëtare duhet të raportojnë të gjitha të dhënat e zbatimit çdo dy muaj dhe Platforma e të Dhënave të Hapura të Kohezionit do të azhurnohet automatikisht.

Një përdorim i shtuar i instrumenteve financiare: Grandët vetëm nuk mund të adresojnë boshllëqet e rëndësishme të investimeve. Ato mund të plotësohen në mënyrë efikase me instrumente financiare, të cilat kanë një efekt levë dhe janë më afër tregut. Mbi baza vullnetare, shtetet anëtare do të jenë në gjendje të transferojnë një pjesë e burimeve të tyre të Politikës së Kohezionit në fondin e ri, të menaxhuar nga qendra e InvestEU, për të hyrë në garancinë e dhënë nga buxheti i BE-së. Kombinimi i grandeve dhe instrumenteve financiare është bërë më i lehtë dhe korniza e re gjithashtu përfshin provizione të veçanta për të tërhequr më shumë kapital privat.

Nomenklatura e njësive territoriale statistikore (NUTS-rajonet) sipas agjencisë statistikore evropiane

Klasifikimi bëhet sipas nivelit NUTS (Nomenclature of territorial Units for Statistics - Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistika) i cili është një sistem hierarkik për të drejtuar dhe orientuar territorin në aspektin ekonomik të BE-së për qëllime të:

1. Mbledhjes, zhvillimit dhe harmonizimit të regjioneve statistikore të Evropës;
Analizës socio-ekonomike të regjionit:
-NUTS 1: regjionet e mëdha socio-ekonomike;⁸
-NUTS 2: regjionet bazike për aplikimin e politikave regjionale;

⁸ <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/>.

-NUTS 3: regionet e vogla për qëllime specifike.

NUTS	NUMRI I BANORËVE (min)	NUMRI I BANORËVE (max)
1	3,000,000	7,000,000
2	800,000	3,000,000
3	150,000	800,000

Mundësitë e Kosovës për përfshirje

Zanafilla e zhvillimit rajonal në Kosovë njihet që më herët, por në aspekt të shfrytëzimit më strukturor të fondeve të BE-së njihet që nga viti 2008. Me iniciativë të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe mbështetjes së Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë (ZBE) janë nënshkruar pesë marrëveshje ndërkomunale të partneritetit për krijimin e pesë Agjencive për Zhvillimin Rajonal (AZHR). Këto marrëveshje janë nënshkruar me 16 dhjetor të vitit 2008.

Në vazhdimësi të kësaj, Qeveria e Kosovës në vitin 2009 ka filluar procesin e planifikimit të Programeve për Bashkëpunim Ndërkufitar të financuara nga BE-ja me shtetet fqinje (Kosovë-Shqipëri; Kosovë-Maqedoni) dhe një vit më vonë Kosovë-Mali i Zi. Në të gjitha këto programe, rajonet e propozuara për përfshirje si zona të pranueshme në program kanë ndjekur klasifikimin evropian të rajoneve NUTS III (edhe pse Kosova nuk ka të aplikuar të njëjtin klasifikim). Si bazë për këtë janë marrë rajonet ekonomike të cilat AZHR-të i përfaqësojnë:

1. Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndër-komunal Qendër⁹ - Rajoni Ekonomik Qendër;
2. Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndër-komunal Lindje - Rajoni Ekonomik Lindje;
3. Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndër-komunal Perëndim - Rajoni Ekonomik Perëndim;
4. Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndër-komunal Jug - Rajoni Ekonomik Jug;
5. Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndër-komunal Veri - Rajoni Ekonomik Veri;

Pas miratimit të Ligjit nr. 08/L-190 për zhvillim rajonal të balancuar, MZHR-ja ka nisur iniciativën për themelimin e dy qendrave të reja për Zhvillim Rajonal në Rajonet Zhvillimore të Juglindjes dhe Jugperëndimit. Dhe kështu po themelohen shtatë qendra për zhvillim rajonal të cilat përputhen me politikat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe Eurostatit për funksionimin dhe operimin e shtatë rajoneve ekonomike-zhvillimore

⁹ Koncept-Dokumenti për Zhvillim Rajonal fq. 6

në Kosovë, e cila përbën njësi të vetme në nivelin NUTS 3, dhe si i tillë klasifikim ky i pranuar nga Eurostat.

Programet Trans-nacionale: Euromed, Danub, Adrion

Kosova për herë të parë në vitin ... ka aplikuar për tu bërë pjesë e programeve trans-nacionale; Euro-MED, Adrion, dhe Danub, me ç' rast zyrtarët e MZHR-së kanë marrë pjesë në disa konferenca lidhur me programimin dhe funksionimin e programeve në fjalë. Pas insistimit të vazhdueshëm të MZHR-së, përmes, shkresave dhe kontaktit me sekretariatet e programeve në fjalë, ministria bën aplikimin veç e veç përmes shkresës zyrtare për secilin program. Ky propozim ishte marr parasysh nga sekretariatet e programeve trans-nacionale dhe ishte shqyrtuar në Komitetet e programeve në fjalë, por, fatkeqësisht propozimi për pranimin e Kosovës si shtet në programet në fjalë kishte dështuar për arsye politike sepse disa nga vendet anëtare të programeve në fjalë, si: Serbia, Sllovakia, Spanja, dhe Greqia votuan kundër, pasi që të njëjtat nuk e njohin ende shtetësinë e Kosovës.

Legjislacioni sekondar:

- Rregullore nr. 21/2024 për Menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar, publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 02.09.2024.
- Rregullore nr. 31/2024 për Standardet, Metodologjinë dhe Sistemin e Hartimit dhe Monitorimit të Planeve Operacionale për Zhvillim Rajonal të Rajoneve Zhvillimore.
- Rregullore nr. 32/2024 për Themelimin, Funksionimin, Organizimin dhe Monitorimin e Qendrave për Zhvillim Rajonal në Rajonet Zhvillimore.
- Rregullore nr. 34/2024 për Performancë Rajonale dhe Monitorim të Zhvillimit socio-ekonomik Rajonal të Balancuar.

Legjislacioni i BE-së për Zhvillim Rajonal të Balancuar

Legjislacioni primar i BE-së

Dispozitat e dala nga Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim, respektivisht Neni 119 i kësaj marrëveshjeje, që parasheh:

- Zhvillimi rajonal dhe lokal - palët do të përpiqen të identifikojnë masat për të forcuar bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe zvogëlimin e pabarazive rajonale.

Kujdes i veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit ndërkufitar, trans-kombëtar dhe ndër-rajonal. Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me acquis të BE-së në fushën e zhvillimit rajonal.

Legjislacioni sekondar i BE-së, konkretisht Rregulloret 1299/2013, 1301/2013, si dhe 1303/2013 të cilat parashohin:

- Rregullore (BE) Nr. 1299/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 17 dhjetor 2013 mbi dispozitat specifike për mbështetjen nga Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal për qëllimin e bashkëpunimit territorial evropian.
- Rregullore (BE) Nr.1301/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 17 dhjetor 2013, për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal dhe dispozitat e posaçme në lidhje me rritjen e investimeve dhe promovimin e punësimit dhe shfuqizimin e Rregullativës (KE) Nr. 1080/2006 është transpozuar në Ligjin nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar.
- Rregullore (BE) Nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 17 dhjetor 2013, për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin e Kohezionit, Fondin Evropian Bujqësor për Zhvillimin Rural dhe Fondin Evropian të Detit dhe Peshkimit dhe duke vendosur dispozita të përgjithshme mbi Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit dhe Fondin Evropian të Detit dhe Peshkimit dhe shfuqizimi i Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1083/2006.

Pas miratimit të Strategjisë për Zhvillim Rajonal 2020-2030, si dhe Planit të veprimit 2023-2025, si dhe Ligjit nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar i cili është miratuar në Qeveri, rregullimi i kësaj fushe me anë të politikave të qarta për zhvillim rajonal sjell progres në aspektin e hartimit të politikave për zhvillim rajonal të balancuar, si në vijim:

1. Barazi rajonale nga aspekti i indikatorëve socio-ekonomik;
2. Hartim të politikave zhvillimore për të nxitur konkurrencë më të madhe në rajon;
3. Ndërlidhje të politikave në mes të politikave sektoriale zhvillimore të qeverisë dhe aktiviteteve në nivele të rajoneve;
4. Stimulim të bashkëpunimit ndër-rajonal, ndërkufitar dhe ndërkombëtarë;
5. Klasifikim të Kosovës sipas rajoneve statistikore NUTS;
6. Krijim të mekanizmave të nevojshme për qasje në fondet zhvillimore të BE-së, dhe për menaxhim të zhvillimit rajonal në përgjithësi.

Referencat:

Politika e Kohezionit Evropian, Komisioni Evropian, 2021;

Politika e Zhvillimit Rajonal të OECD-së, 2020;

Strategjia për Zhvillim Rajonal 2020-2030, MZHR;

Eurostat - Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistika (NUTS);

Ligji nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar, Kosovë.